



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PARLAMENTAR PËR INTEGRIMIN EUROPIAN

Datë 12.02.2019

Dokument Parlamentar

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN
“PËR SKEMAT E CILËSISË SË PRODUKTEVE BUJQËSORE DHE USHQIMORE

- ***Hyrje***

Komisioni për Integrimin European (në vijim Komisioni), bazuar në Nenet 18, 32, 34 dhe 38 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në mbledhjen e zhvilluar në datë **12.02.2019**, me cilësinë e Komisionit **për dhënie mendimi**, mori në shqyrtim projektligjin “***Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore***”.

Për paraqitjen e këtij projektligji, në mbledhje ishte e pranishme Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural e përfaqësuar nga Z. Ilir Halilaj, Zëvendësministër

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Ky projektligj është nismë e Këshillit të Ministrave i propozuar nga Ministria e Bujqësisë dhe zhvillimit Rural, në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës,

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë neni 78 dhe Rregullores së Kuvendit, neni 55 pika 1 ky projektligj kërkon shumicë të thjeshtë votash për miratim.

- ***Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit***

Projektligji ka për qëllim përcaktimin e rregullave për funksionimin e sistemit të cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore si dhe detyrat e kompetencat e organeve përgjegjëse për:

- vlerësimin e aplikimeve për regjistrimin e emërimit “Specialitet tradicional i garantuar”;
- verifikimin e përputhshmërisë me specifikimet e produktit për kërkesat për regjistrim të emërtimeve të origjinës dhe të treguesve gjeografikë për produktet bujqësore dhe ushqimore, siç përcaktohet në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 178, të ligjit nr.9947, datë 7.7.2008 “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar;
- verifikimin e përputhshmërisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore të regjistruara si STG, EOM dhe TGJM, para vendosjes së tyre në treg;
- kryerjen e kontroleve zyrtare për të verifikuar përputhshmërinë e produkteve bujqësore dhe ushqimore të regjistruara si STG, EOM dhe TGJM me kërkesat e përcaktuara në këtë projektligj;

- vlerësimin e aplikimeve për skemat e tjera të cilësisë për produktet bujqësore dhe ushqimore, të cilat nuk janë pjesë e tri skemave (STG, EOM, TGJM).

- ***Vlerësimi i Ligjshmërisë Kushtetuese dhe harmonizimi me legjislacionin në fuqi dhe aktet ndërkombëtare.***

Projektligji është në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë. Ky projektligj përaftron pjesërisht rregulloren e BE-së, nr.1151/2012, “Për Skemat e Cilësisë për produktet bujqësore dhe ushqimore”, si dhe plotëson detyrimet që rrjedhin nga ligji nr.9947, datë 7.7.2008, “Për pronësinë industriale”, të ndryshuar, nenet: 176, 178, 182/c dhe 182/ç.

- ***Vlerësimi i përputhshmërisë së projektligjit me Acquis të BE-së***
projektligjin “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”

Plani Kombëtar për Integrimin European 2017-2020

Ky projektligj është në përputhje me objektivat strategjikë dhe prioritetet e parashikuara në **Kapitullin 11 “Bujqësia Dhe Zhvillimi Rural”** të Planit Kombëtar për Integrimin European (PKIE) 2017-2020.

Aspektet procedurale të përafrimit

- Neni 70 i MSA-së njihet rëndësinë dhe parashikon detyrimin e përafrimit të legjislacionit Shqiptar me atë të Bashkimit European;
- Neni 17, pika 2 e ligjit Nr.15/2015 “Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin European”, përcakton se projektligjet e paraqitura nga Këshilli i Ministrave shoqërohen me tabelën që analizon shkallën e përputhshmërisë me të drejtën e Bashkimit European;
- Neni 68, pika 2 e Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë parashikon që Projektligjet duhet të shoqërohen me një relacion shpjegues, i cili përmban vlerësimin e harmonizimit të projektligjit me legjislacionin e BE-së.

Aspektet materiale të përafrimit

Acquis e BE-së që përafrohet nga Projektligji i propozuar:

Legjislacioni parësor i BE-së:

- Traktati mbi Funksionimin e Bashkimit European (TFBE): Pjesa e Tretë “Politikat dhe Veprimet e Brendshme të Bashkimit”, Titulli III “Bujqësia dhe peshkimi”, **neni 38** (ish-neni 32 TKE), **neni 39** (ish-neni 33 TKE), **neni 43, pika 2** (ish-neni 37 TKE), **Shtojca I**; Titulli VII “Rregullat e Përbashkëta për Konkurrencën, Tatimet dhe Përafrimin e Legjislacionit”, Kreu 3 “Përafrimi i Legjislacionit”, **neni 118, paragrafi i parë.**
- Marrëveshja e Stabilizim Asociimit BE - Shqipëri (MSA): Kapitulli II “Bujqësia dhe peshkimi”, **Nenet 24, 25, 26 dhe 27, Shtojcat II (a), II (b), II (c)**; Titulli VIII “Politikat e bashkëpunimit”, **Neni 95 “Bujqësia dhe sektori agro-industrial”.**

Legjislacioni dytësor i BE-së:

- **Rregullorja (BE) Nr. 1151/2012 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 21 Nëntor 2012 “Mbi skemat e cilësisë për produktet bujqësore dhe ushqimore”, e ndryshuar¹”.**

Niveli i Përafrimit: I pjesëshëm

- Shkalla e përafrimit në tërësi të projektligjit të paraqitur me *acquis* të BE-së është e pjesshme. Pra, projektligji në fjalë është në përputhje (nuk bie në kundërshtim) me dispozitat e burimeve parësore dhe dytësore të Acquis të BE-së të lartpërmendura, por nuk është në përputhje me të gjitha parimet që rrjedhin prej këtyre dispozitave.
- **Konsultimi publik (nëse i është nënshtruar këtij procesi)**

Nuk ka patur konsultim publik në Komision për Integrimin Evropian

- **Efektet financiare të aktit (nëse ka)**

Projektligji parashikon efekte financiare, të cilat do të përcaktohen më mirë me aktet nënligjore përkatëse, të përcaktuara në nenin 36, të projektligjit, duke specifikuar dhe organet/institucionet përgjegjëse për këto akte. Do të propozohen edhe ndryshimet përkatëse në vendimin nr.656, datë 31.10.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të përhershme të njësive të qeverisjes qendrore”. Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural këto efekte do t’i përballojë nga buxheti i akorduar, pa kosto financiare shtesë.

Është llogaritur që shpenzimet e mundshme të jenë, afërsisht, 3.1 milionë lekë/vit, ndërkohë që të ardhurat të arrijnë dyfishin e tyre.

- **Diskutimi në komision**

Gjatë diskutimeve në Komisionin për Integrimin Evropian u parashtua edhe çështja e mungesës së paraqitjes së plotësisht të rekomandimeve të Agjendës 2030 për zhvillimin e qëndrueshëm. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka miratuar një rezolutë në lidhje sa më sipër dhe i është drejtuar qeverisë shqiptare për paraqitjen në relacionin shoqërues të projektligjit përmbushjen e detyrimeve të vendosura në Agjendën 2030 dhe në rezolutën e Kuvendit.

- **Ndryshime të projektaktit (nen për nen)**

1. SHQYRTIMI I PËRPUTHSHMËRISË SË DISPOZITAVE TË PROJEKTLIGJIT ME ACQUIS TË BE

¹ E ndryshuar nga Rregullorja (BE) 2017/625 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 15 mars 2017, me efekt nga data 14 dhjetor 2019.

Nga shqyrtimi i përputhshmërisë së projektligjit të propozuar me *acquis* të BE-së rezulton se për një përafrim më të saktë me legjislacionin dytësor të lartpërmendur është e nevojshme që në tekstin e tij të bëhen disa shtesa dhe ndryshime si vijon:

1. Shënimi në fund të faqes që lidhet me titullin e projektligjit të riformulohet si vijon:

“Ky ligj është përafruar pjesërisht me:

- ***Rregulloren (BE) Nr. 1151/2012 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 21 Nëntor 2012 “Mbi skemat e cilësisë për produktet bujqësore dhe ushqimore”, e ndryshuar. Numri CELEX 32012R1151, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, Seria L, nr.343, datë 14.12.2012, faqe 1-29”.***

2. Në nenin 18, pika 1 të projektligjit që të bëhet korrigjimi si më poshtë:

“1. Çdo person fizik ose juridik shqiptar, që ka një interes ligjor për të paraqitur një kundërshtim lidhur me kërkesën për regjistrim të emërimit STG ose ndryshim të specifikimeve për emërtimin STG për produktet bujqësore ose ushqimore, në përputhje me legjislacionin evropian për skemat e cilësisë, njofton ministrinë me shkrim, brenda 2 muajve, nga data e publikimit në **Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian**”.

3. Pika 2 e nenit 23 të projektligjit, të riformulohet si vijon:

“2. Trupa certifikuese miratohet nëse është e akredituar në përputhje me **Standardin European EN 45011** ose ISO/IEC17065, sipas legjislacionit në fuqi në fushën e akreditimit.”

- ***Rekomandime***

Të dërgohet në Komisioni për Integrimin Evropian pjesa e munguar në lidhje me Agjendën 2030 dhe të përfshihet në relacionet e projektligjeve sipas Rezolutës së Kuvendit të Shqipërisë

- ***Përfundim***

- Komisioni për Integrimin Evropian:
- pasi vlerësoi qëllimin e projektligjit, procedurat ligjore sipas detyrimeve kushtetuese dhe të Rregullores së Kuvendit;
- pasi vlerësoi përputhshmerinë e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian si detyrim i Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, neni 70;
- pasi propozoi ndryshimet e nevojshme për përmirësimin e dispozitave dhe
- pasi konsideroi se projektligji votohet me mazhorancë të thjeshtë,

e votoi aktin ligjor të propozuar nga Këshilli i Ministrave në parim, nen për nen dhe me ndryshime në tërësi dhe me shumicë votash **e miratoi** atë dhe vendosi për vijimin e procedurës sipas Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

NËNKRYETARE

SENIDA MESI